

VENDIM
Nr. 359, datë 20.5.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 385, DATË 10.7.2025, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË PËRBËRJE TË
GRUPBATALIONIT SHUMËKOMBËSH TË NATO-s, NË OPERACIONIN E FORCËS
SË PËRPARUAR TOKËSORE (*FORWARD LAND FORCE*), DREJTUAR NGA NATO-
ja, NË *NOVO SELO*, BULLGARI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalja e dytë, e pikës 4, të vendimit nr. 385, datë 10.7.2025, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përbërje të grupbatalionit shumëkombësh të NATO-s, në operacionin e Forcës së Përparuar Tokësore (*Forward Land Force*), drejtuar nga NATO-ja, në *Novo Selo*, Bullgari” zëvendësohet me “... Kohëzgjatja për çdo rotacion është deri në 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrje dhe dorëzim detyrë, si dhe vonesa për transportin strategjik.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu